



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
KËSHILLI I BASHKISË
KORÇË

VENDIM
Nr 140 Datë 22/12/2008

PER

Kalimin e inventarit të mjeteve kryesore nga Bashkia tek institucionet e vartësisë

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, i mbledhur në datën e sotme, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Financës për « **Kalimin e inventarit të mjeteve kryesore nga Bashkia tek Institucionet e vartësisë** », bazuar në ligjin nr. mbi 8652 dt. 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" neni 8 pika II/a dhe II/c, ligjin nr. 9836 dt. 26.11.2007 « Per buxhetin e Shtetit te vitit 2008 », Udhezimin nr.4 dt.17.01.08 i M.F « Per zbatimine buxhetit te shtetit per vitin 2008 ».Udhezimin nr 258 dt. 15.02.2008 i Ministrise se Brendshme « Per zbatimin e buxhetit te qeverisjes vendore per vitin 2008 », V.K.B nr. 12 dt. 18.03.2008 « miratimin e buxhetit te Bashkise dhe institucioneve te vartesisë per vitin 2008 », Ligji nr. 9936 date 26.06.2008 « Per menaxhimin e sistemit buxhetor ne Republiken e Shqiperise », VKM nr 153 dt. 03.04.1993 "Për kalimin e objekteve të mjeteve kryesore të ndërmarrjeve dhe institucioneve shtetërore", ligji nr 6942 dt. 25.12.1984 "Per administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale dhe monetare", VKM nr 70 dt. 11.03.1985 "Per administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave monetare", ndryshuar me VKM nr. 170 dt. 03.04.0993 "Per disa ndryshime ne VKM nr 70dt. 11.03.0985, "Per administrimin, ruajtjen , dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale dhe monetare mbështetur në kompetencat që ka si dhe mbas diskutimit të anëtarëve:

VENDOSI

1. Të miratoje kalimin e inventarit të mjeteve kryesore nga bashkia tek Institucionet e vartësisë si më poshtë:

Viti 2005, sistemim asfaltim lulishte Themistokli Germenji me vlerë: 3.409.338 lekë nga Bashkia tek NSHP.

Viti 2006, rikonstruksion i lulishtes Vangjush Mio me vlerë: 1.077.857 lekë nga Bashkia tek NSHP.

Viti 2008, blerje tabela treguese me vlerë 662.928 lekë nga Bashkia tek NSHP.

Viti 2005, lyerje fasade Kolegji "Preka" me vlerë 299.400 lekë nga Bashkia tek Kolegji "Preka", sipas Akt Marreveshjes lidhur midis Bashkise Korce dhe Kolegjit Preka

Viti 2005, meremetim pallati i sportit Tamara Nikolla me vlerë 2.405.404 lekë nga Bashkia tek Klubi Shumësportësh.

Viti 2006, rikonstruksion Teatri A.Z. Cajupi me vlerë 6.939.190 lekë nga Bashkia tek Teatri.

Viti 2006, rikonstrukcion biblioteka "Thimi Mitko" me vlerë 6.095.782 lekë nga Bashkia tek Biblioteka.

Viti 2006, rikonstrukcion galeria "Guri Madhi" me vlerë 1.407.710 lekë nga Bashkia tek Qendra ekonomike e Kulturës.

Viti 2008, blerje materiale për përgatitjen e fushës së stadiumit me vlerë 5.958.816 lekë nga Bashkia tek Klubi i Futbollit.

3.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Institucionet e vartësisë.

4.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetari

Raimonda Nase

Raimonda Nase

Dixhitalizuar nga Qendra QIP
www.infocip.org